

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“HAPPINESS ENTERTAINMENT” SH.P.K.**

Sot, më 18/03/2024, në Tiranë, themeluesi,

Gjergji Marga, i lindur më 03.10.1979 në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, i pajisur me letërnjoftimin me numër 034532222 dhe me numër personal H91003129M, me banim në adresën: Rruga “Fortuzi”, në Tiranë, Shqipëri, ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1
Themelimi**

- Emri i shoqërisë është “HAPPINESS ENTERTAINMENT” SH.P.K.
- Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 2

Objekti

1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
 - a) Prodhimi, riprodhimi, shpërndarja në Shqipëri dhe jashtë saj, komunikimi në publik përmes përcjelljes në publik, transmetimit dhe ritransmetimit, vendosjes në dispozicion të publikut me anë të internetit, vendosjes në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese, shfrytëzimi në mënyrë digjitale në internet me anë të vënies në dispozicion të publikut nëpërmjet shpërndarjes përmes shitjes me anë të shkarkimeve dhe me anë të streaming, shfrytëzimi në mënyrë digjitale në internet me anë të monetizimit i veprave audiovizuale, që përfshijnë filmat kinematografikë, televizivë, e animuar, reklamat, filmat e tjere, videot e shkurtëra muzikore, dokumentarët, programet televizive dhe formatet televizive të llojit reality show, gjysmë reality show, emisionet televizive dhe grafikate televizive.
 - b) Prodhimi i fonogrameve të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës. Riprodhimi, shpërndarja, qiradhënia, huadhënia, ritransmetimi kabllor, vënia në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese e fonogrameve të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës; shfrytëzimi në mënyrë digjitale në internet nëpërmjet vënies në dispozicion të publikut përmes shpërndarjes me anë të shitjes me anë të shkarkimeve dhe me anë të streaming të fonogrameve të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës; shfrytëzimi në mënyrë digjitale në internet me anë të monetizimit të fonogrameve të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës, si pjesë përbërëse e veprave audiovizuale.
 - c) Blerja dhe shitja nëpërmjet kalimit në formë ekskluzive ose jo ekskluzive të të drejtave pasurore të kompozimeve muzikore me ose pa tekst, të të drejtave pasurore të krijimeve të fjalës, të shprehura nëpërmjet shkrimeve letrare, publicistike, si dhe çdo krijim tjetër me gojë ose me shkrim, të lajmeve si dhe të informacioneve të shtypit që kanë karakter të thjeshtë informimi.
 - d) Shfrytëzimi i kompozimeve muzikore me ose pa tekst përmes riprodhimit, shpërndarjes, qiradhënies, komunikimit në publik, huadhënies publike, përshtatjes, aranzhimit muzikor si dhe çdo transformimi tjetër, vënies në dispozicion të publikut në mënyrë digjitale në internet me anë të shkarkimeve, me anë të streaming, me anë të monetizimit.
 - e) Shfrytëzimi i krijimeve të fjalës, të shprehura nëpërmjet shkrimeve letrare, publicistike, si dhe të çdo krijimi tjetër me gojë ose me shkrim, të lajmeve si dhe të informacioneve të shtypit që kanë karakter të thjeshtë informimi përmes riprodhimit, shpërndarjes, qiradhënies, komunikimit në publik, huadhënies publike, përshtatjes, përkthimit si dhe çdo transformimi tjetër, vënies në dispozicion të publikut në mënyrë digjitale me anë të shkarkimeve, me anë të streaming, me anë të monetizimit.
 - f) Blerja dhe shitja përmes kalimit në formë ekskluzive ose jo ekskluzive të të drejtave pasurore të interpretimit dhe/ose ekzekutimit të artistëve interpretues dhe/ose ekzekutues të aktorëve, këngëtarëve, muzikantëve, valltarëve dhe personave të tjerë, të cilët paraqesin, aktrojnë, këndojnë, recitojnë, luajnë, interpretojnë, ekzekutojnë, ose që shfaqin në mënyra të tjera vepra letrare dhe artistike, një shfaqje të çdo lloji, përfshirë format e shprehjes së folklorit, varietete, shfaqjet e cirkut ose shfaqjet me kukulla.

- g) Drejtimi, zhvillimi, udhëheqja dhe mbrojtja e karrierës artistike profesionale e artistëve interpretues dhe/ose ekzekutues, në të cilët përfshihen aktorët, këngëtarët, muzikantët, valltarët dhe personat e tjerë, të cilët paraqesin, aktojnë, këndojnë, recitojnë, luajnë, interpretojnë, ekzekutojnë, ose që shfaqin në mënyra të tjera vepra letrare dhe artistike, një shfaqje të çdo lloji, përfshirë format e shprehjes së folklorit, varietete, shfaqjet e cirkut ose shfaqjet me kukulla.
- h) Organizimi, prodhimi i veprimtarive artistike të çdo lloji, përfshirë koncertet muzikore të çdo lloji.
- i) Organizimi i kurseve të formimit profesional në disiplinën e ndryshme të artit dhe kulturës për fëmijë dhe të rinj.
- j) Organizimin e veprimtarive kulturore dhe edukative për fëmijë, të rinj dhe të rritur.
- k) Botimi, prodhimi, riprodhimi dhe shpërndarja e revistave, gazetave, e krijimeve të fjalës të shprehura nëpërmjet shkrimeve letrare, publicistike, shkencore si dhe të çdo krijimi tjetër me shkrim. Komunikimi në publik përmes shfaqjes publike në faqet e internetit të krijimeve të fjalës, të shprehura nëpërmjet shkrimeve letrare, publicistike, shkencore, të çdo krijimi tjetër me gojë ose me shkrim, të lajmeve si dhe të informacioneve të shtypit që kanë karakter të thjeshtë informimi.
- l) Prodhimi, shpërndarja, komunikimi në publik i krijimeve fotografike, duke përfshirë veprat fotografike si dhe të çdo krijimi tjetër që shprehet nga çdo proces i ngjashëm me atë fotografik.
- m) Krijimi i faqeve të internetit, mirëmbajtja dhe tregtimi i faqeve të internetit.

Neni 3: Kohëzgjatja

2. Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Neni 4: Selia

1. Shoqëria e ka selinë në: Rruga “Mahmut Fortuzi”, Ndërtesa nr. 119, Hyrja nr. 2, Ap. nr. 1, Tiranë, Republika e Shqipërisë.
2. Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyrë përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Neni 5 Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1000 (njëmijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë. Pjesëmarrja e themeluesit të vetëm të shoqërisë Gjergji Marga në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtëm:
 - Ortaku themelues Gjergji Marga është zotëruar i vetëm i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1000 (njëmijë) Lekë, që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer dhe nënshkruar tërësisht nga ortaku i vetëm themelues i shoqërisë.
3. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6 **Administratori**

1. Administratori i shoqërisë emërohet Gjergji Petraq Marga, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të kartës së identitetit me numër 034532222 dhe me numër personal H91003129M, i datëlindjes 03.10.1979, lindur në Tiranë dhe banues në adresën: Rruga "Fortuzi", Tiranë, Shqipëri, me afat emërimi 5 vjeçar.

Neni 7 **Baza Ligjore**

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8 **Mosmarrëveshjet**

1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

ORTAKU I VETËM **I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR** **"HAPPINESS ENTERTAINMENT" SH.P.K.**

GJERGJI MARGA



(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)